



Biografi e shkurtër

Elona Fama, Këshilltare Ligjore

Znj Elona Fama në vitin 1999, është diplomuar me titullin “Jurist” në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës.

Në vitin 2013, ka fituar titullin “Avokat” të akorduar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë Tiranë.

Ka një përvojë pune rreth 21 vite si specialiste në administratën publike, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës e Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Shërbimin Kombëtar të Punësimit, Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), duke mbajtur funksione të ndryshme si, specialiste, specialiste e marrëdhënieve të punës, juriste në sektorin e burimeve njerëzore, juriste në sektorin e legalizimit, specialiste e ndjekjes dhe trajtimit të ankesave administrative dhe proceseve gjyqësore etj.

Ka marrë pjesë në një sërë aktivitetesh trajnuese që lidhen me veprimtarinë e administratës publike si: aspektet e punës me informacionin dhe dokumentacionin; prokurimin publik; kompetencat themelore mbi ekonominë shqiptare, tregun shqiptar të punës, arsimin dhe formimin profesional.

Ka njohuri shumë të mira të gjuhës angleze dhe italiane.

Prej datës 26 prill 2023, mban pozicionin e Këshilltares Ligjore në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, pranë Gjykatës Kushtetuese.